

## AKSIONI ANTI- INFORMALITET

Në kuadër të aksionit antiinformalitet po kryhen kontrole në të gjitha subjektet të cilat nxjerrin, përpunojnë apo tregtojnë karburante. 550 ton karburant në rafinerinë e Ballshit u bllokua nga ana e strukturave të ISHTI-t pasi parametrat nuk përmbushnin standardet e kërkuara. Kjo sasi karburanti do të ripërpunohet sërish dhe më pas do t'i nënshtrohet një tjetër kontrolli ku vetëm pasi të ketë përmbushur standardet e kërkuara do të lejohet për t'u tregtuar.

## UNAZA E MADHE E TIRANËS

Punimet në pjesën lindore të Unazës së Madhe të Tiranës po vijnë me ritme të kënaqshme. Projekti për këtë vepër të rëndësishme parashikon jo vetëm ndërtimin e rrugës, por përfshin edhe rikualifikimin e të gjithë zonës, sistemimin e shtratit të lumit Lana si dhe krijimin e hapësirave të gjelbërta për qytetarët.

## SHEMBET DIGA E HEC-IT NË HOLTË

Ashtu siç ishte premtuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, HEC-i i nisur në afërsi të Kanionit të Holtës në Bashkinë e Gramshit nuk do të ndërtohet. Pas dëgjësive me banorët, MIE së bashku me autoritetet e tjera, ka bërë të mundur shembjen e digës së betonit e ndërtuar në afërsi të Kanionit. Puna do të vijojë deri në kthimin e territorit në të njëjtën gjendje në të cilën ishte para se të realizoheshin punimet.

## DPSHTRR, REZERVIM ONLINE PËR 9 SHËRBIME

Prej datës 20 gusht ofrohet rezervimi online për 9 shërbime kryesore në sportelet e DPSHTRR. Tashmë qytetarët mund të zgjedhin vetë online kohën se kur do të paraqiten pranë sporteleve. Rezervimi mund të bëhet për ndryshimin e pronësisë mbi mjetin, kontratë shitblerje, humbja, vjedhja, dëmtimi i targës apo lejes së qarkullimit, ndryshimi i vendbanimit ose gjeneraliteteve të pronarit, ndryshimi i karakteristikave konstruktive të mjetit si dhe çregjistrim i përkohshëm ose i përhershëm i mjetit.

## AKSI QAFË KASHAR-RINAS

Autoriteti Rrugor Shqiptar vijon punën për mirëmbajtjen e të gjitha akseve kombëtare. Gjatë kësaj jave në aksin Qafë Kashar-Rinas u bë e mundur rregullimi i ndriçimit përgjatë gjithë këtij segmenti. Grupet e punës riparuan 15 siguresa, si dhe 4 paketa të dëmtuara që ishin nëntokë duke e bërë këtë aks më të sigurt për të gjithë përdoruesit e tij.

## TASK FORCA E TRANSPORTIT RRUGOR

Kamera në trup për inspektorët e Task Forcës së Transportit Rrugor. Tashmë procesi i verifikimit është më transparent përmes provave filmike. Monitorim me zë dhe figurë gjatë kontrolleve si dhe ndërlidhje në kohë reale duke i dhënë fund abuzimeve të mundshme. Gjithashtu blica sinjalizuese për manovër më të sigurtë në terren, ditën dhe natën.